REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA GRAMSH
DREJTORIA JURIDIKE, BURIMEVE NJERËZORE

Nr. 4213/2 prot. Gramsh, më 29.10.2026

NJOFTIM MBI REZULTATET E VERIFIKIMIT PARAPRAK PËR NGRITJEN NË DETYRË NË SHËRBIMIN CIVIL NË KATEGORINË E MESME DREJTUESE (*Drejtor në Drejtorinë Juridike, Burimeve Njerëzore*)

Lloji i diplomës "*SHKENCAT JURIDIKE*" niveli minimal i diplomës Master Shkencor"

Në zbatim të nenit 26 të ligjit 152/2013 *"Për nëpunësin civil"*, i ndryshuar, si dhe të Kreut III, të Vendimit Nr. 242, datë 18/03/2015, të Këshillit të Ministrave,

Njësia e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore në Bashkinë Gramsh në përfundim të verifikimit paraprak të kandidatëve, për përmbushjen e kushteve të ngritjes në detyrë në shërbimin civil dhe kërkesave të veçanta të shpallura në shpalljen për konkurrim, njofton se kandidatët e kualifikuar për të vazhduar fazën e dytë të testimit, janë:

1. **Marije Kola**

Testimi me shkrim dhe intervista me gojë (pas testimit me shkrim) do të zhvillohen, në ambientet e Bashkisë Gramsh, sallën e mbledhjeve në datën 18.11.2026 ora 11.00. Kandidatët të cilët kanë grumbulluar në vlerësimin me shkrim më shumë se gjysmën e pikëve do të kalojnë në intervistën e strukturuar me gojë.